



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 10, datë 31.01.2018**

**PËR**  
**MIRATIMIN E LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE BROKERIMI NË**  
**SIGURIME NË KLASAT JETË, JO-JETË DHE RISIGURIME,**  
**TË SHOQËRISË “SUNTRUST BROKER” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe të nenit 204 dhe 211, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Licencimin e shoqërisë “SunTrust Broker” sh.a., për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në sigurime për klasat e Jetës, Jo-Jetës dhe risigurime, për një periudhë pa afat.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**